

ALARM 11

SA DHE PËR ÇFARË E KEMI TË SHKURTËR JORGANIN?

NË ÇFARË MËNYRE E KONTROLLUAM?

Prej vitit 2011, për kalkulim të shpenzimeve të nevojshme për jetë, Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë (LSM) e përdor instrumentin shporta minimale sindikale (SHMS). SHMS i mat shpenzimet në shtatë grupe themelore të produkteve dhe mallrave, edhe atë:

- 1 ushqim dhe pije (63 artikuj, të cilat ndonjë nuk i pasqyrojnë nevojat e plota të ushqimit, i shprehin mundësitë, shprehitë dhe traditën në të ushqyerit, edhe atë në vlerë minimale);
- 2 shtëpi (shpenzime komunale me pesë elemente dhe materiale shtëpie, pajisje për shtëpi dhe mirëmbajtje - 13 mallra);
- 3 higjienë (7 produkte për higjienë personale dhe shtëpiake; sasi minimale me çmime më të ulta);
- 4 transport (dy bileta mujore për transport publik);
- 5 veshje dhe veshmbathje (nga një pjesë për secilin anëtar të familjes për secilën stinë);
- 6 kulturë (një herë në kinema, një gazetë javore dhe një ditore); dhe
- 7 mirëmbajtje dhe shëndet (nuk përfshin medikamente për sëmundje kronike).

Në përgjithësi, SHMS supozon që një amvisëri përbëhet nga një familje prej katër anëtarëve dhe jeton në shtëpi prej 50 m² dhe nuk posedon automjetet. Në shportën nuk janë përfshirë shpenzimet për rekreim, arsim, hotele dhe restorante, festime familjare dhe shpenzime tjera të ngjashme.

ÇFARË KONTROLLUAM?

Ne i krahasuam të dhënat për vlerat e viteve 2012 dhe 2013 për: a) familje prej katër anëtarëve që jeton në shtëpi prej 50 m², nuk posedon automjetet dhe merr një rrogë mesatare, b) familje prej katër anëtarëve/amvisëri që në pajtim me Ligjin për Mbrojtje Sociale (Neni 47) merr për 3 vitet e para 100% të shumës së caktuar për ndihmë sociale, dhe c) familje prej katër anëtarëve/amvisëri që në pajtim me Ligjin për Mbrojtje Sociale (Neni 48), pas skadimit të vitit të tretë, merr 50% të shumës së caktuar të ndihmës sociale.

Dhe prandaj ja për sa e kemi të shkurtër jorganin, të shprehur në denarë:

	Shpenzime të nevojshme SHMS	Rrogë mesatare e paguar dhe shuma e ndihmës sociale	Mungesë për amvisëri, në muaj	Mungesë për person, në muaj	Mungesë për person, në ditë
2012					
Amvisëri prej katër anëtarëve me një rrogë mesatare	31.468	20.903	10.565	2.641	88
Amvisëri prej katër anëtarëve me 100% ndihmë sociale	31.468	4.926	26.542	6.635	221
Amvisëri prej katër anëtarëve me 50% ndihmë sociale	31.468	2.463	29.005	7.251	242
shumat janë të llogaritura në denar					
2013					
Amvisëri prej katër anëtarëve me një rrogë mesatare	32.235	21.114	11.121	2.780	93
Amvisëri prej katër anëtarëve me 100% ndihmë sociale	32.235	4.926	27.308	6.827	227
Amvisëri prej katër anëtarëve me 50% ndihmë sociale	32.235	2.463	29.772	7.443	248
shumat janë të llogaritura në denar					

Për derisa bilanci i kuq zmadhohet, numri i përdoruesve të ndihmës sociale edhe më tutje zvogëlohet:



Numri i amvisërive që janë përdorues të ndihmës sociale

2006	64.517
2009	49.515
2010	44.940
2011	36.991
2012	33.717
2013	Nuk ka të dhëna

ndërsa numri i gjiro llogarive të bllokuara në janar të vitit 2014 është rritur në 207.086, prej të cilëve 64.479 kanë qenë të kompanive ndërsa 142.607 të qytetarëve (burim: Utrinski vesnik, 14.02.2014). Praktika e bllokimit të llogarive të marrësve të ndihmës sociale, në çfarëdo baze, është shkelje e rëndë e Ligjit për Ekzekutim (Nenet 5, 84 dhe 104).

Dhe a është për tu krenuar „suksesi” që në vitin 2013 disa prej nesh ditën e kanë jetuar me 20 denarë, gjegjësisht 40 denarë nëse amvisëria ka qenë marrëse e ndihmës sociale, ndërsa 176 denarë nëse në amvisëri ka pasur të ardhura nga një rrogë?

Kush e ka llogaritur që për shpenzimet më të nevojshme të mjaftojnë 704 denarë nëse amvisëria ka një rrogë, 164 denarë për amvisërinë që merr shumë të plotë të ndihmës sociale ndërsa 82 denarë për amvisërinë e cila merr 50% të shumës së ndihmës sociale?



FOUNDATION / ФОНДАЦИЈА
OPEN SOCIETY / ОТВОРЕНО
SOCETY / ОПШТЕСТВО
MACEDONIA / МАКЕДОНИЈА

8th Септември
8 Shtatori